

V E N D I M
Nr. 112, datë 18.3.1999

**PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR
SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" DHE TË LIGJIT
NR.7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË"**

(Ndryshuar me VKM nr. 384, datë 14.7.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. SIGURIMI I DETYRUESHËM

Në kuptim të neneve 2 dhe 9 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, quhen persona të mbrojtur:

1. Personat e punësuar sipas një kontrate pune pa afat, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për paaftësi të përkohshme në punë, barrëlindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësi dhe në sigurimin shëndetësor.

2. Personat e punësuar sipas një kontrate pune pa afat, që punojnë më pak se 24 orë në javë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për barrëlindje, pensione dhe në sigurimin shëndetësor në nivelin minimal.

3. Personat e punësuar sipas një kontrate pune me kohëzgjatje më pak se tre muaj në vit, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për paaftësi të përkohshme, barrëlindje, aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe në sigurimin shëndetësor.

4. Personat e punësuar sipas një kontrate pune, me kohëzgjatje më pak se koha maksimale javore e punës në një punëdhënës gjatë gjithë vitit, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe në sigurimin shëndetësor.

5. Personat e tjerë ekonomikisht aktivë në subjekte private (punëdhënës dhe të vetëpunësuar), që kanë të ardhura nga një veprimtari ekonomike, pavarësisht nga kohëzgjatja e saj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për barrëlindje, për pensione dhe në sigurimin shëndetësor.

6. Të vetëpunësuarit në bujqësi të aftë për punë e që janë në moshën 16 vjeç deri në 60 vjeç për burrat dhe 16 vjeç deri 55 vjeç për gratë dhe që nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, sigurohen në mënyrë të detyrueshme për barrëlindje, për pensione dhe në sigurimin shëndetësor.

Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin dhe personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, me moshë mbi 16 vjeç mbrohen dhe sigurohen vetëm për sigurimin shëndetësor,

II. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në kuptim të neneve 2,32,36 dhe 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, shuma bazë e pensioneve nga data 1.7.2000 e në vazhdim është 5 148 lekë në muaj.

2. Në kuptim të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, për personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitim të masës së pensionit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, niveli i pensionit, nga data 1.7.2000 e në vazhdim, është 1 328 lekë në muaj.

III. Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve

Në kuptim të neneve 9, 10, 14 dhe 90 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 dhe të neneve 8, 9, 10, 11 dhe 12 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 për masën, kriteret dhe mënyrën e derdhjes së kontributeve, përcaktohet si vijon:

1. *Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën 1.7.2000 e në vazhdim, është 3 568 lekë.*

2. Punëdhënësi bën sigurimin e personave të punësuar nga dita që punëmarrësi fillon punën me pagesë, mbështetur në një kontratë pune dhe e vazhdon atë gjatë gjithë kohës që punëmarrësi është në marrëdhënie pune. *Për të punësuarit, punëdhënësi derdh kontribut të detyrueshëm në masën 45.9 për qind të listëpagesave, në kufijtë e pagës mujore minimale 7 773 lekë dhe maksimale 23 319 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim.*

3. *Për vetëpunëdhënësit privatë dhe të vetëpunësuarit (duke përjashtuar të vetëpunësuarit në bujqësi) derdhin kontribut të detyrueshëm në masën 41.5 për qind të pagës mujore minimale 7 773 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim.*

4. Për punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit, periudha e detyrimit ndaj sigurimeve shoqërore, fillon ditën kur personi ka filluar ligjërisht veprimtarinë ekonomike dhe mbaron ditën kur përfundon ligjërisht kjo veprimtari. Ndërprerjet e veprimtarisë gjatë vitit kalendarik vërtetohen nga organet përkatëse. Personave fizikë e juridikë privatë, nuk u jepet e drejta e fillimit të veprimtarisë nga degët e tatim-taksave, nëse nuk paraqesin aktin e regjistrimit në organet e sigurimeve shoqërore, si dhe nuk i jepet leja e vazhimit të veprimtarisë për vitin vijues, nëse nuk paraqesin vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me të vetëpunësuarin dhe personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, me moshë mbi 16 vjeç, që nuk kanë ndonjë punësim tjetër, paguajnë kontribut të sigurimit shëndetësor në masën 7 për qind të pagës mujore minimale 7 773 lekë dhe maksimale 23 319 lekë, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim.

6. Të vetpunësuarit në bujqësi derdhin kontribut vjetor në masën 15 për qind të të ardhurave fikse vjetore 10800 lekë, e barabartë me 1620 lekë. Përjashtimisht, për rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë, masa e kontributit vjetor do të jetë 9 për qind, e barabartë me 972 lekë.

Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore për vitet në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguruar për vitet e mëparshme. Periudhat për të cilat nuk janë paguar kontributet nuk njihen periudha sigurimi.

Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë vetë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, një herë në tri muaj.

Përjashtohen nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror, familjet e të vetë punësuarve në bujqësi, që përfitojnë nga ligji nr.7710, datë 18.5.1995 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore". Periudhat gjatë të cilave përfitohet nga ky ligj, nuk njihen periudha sigurimi.

Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë, së bashku me kontributet e sigurimeve shoqërore, kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore në masën 5 për qind të pagës minimale mujore prej 900 lekësh, e barabartë me 45 lekë në muaj. Rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë e Tropojë, masën e kontributit e kanë 3 për qind të pagës minimale mujore prej 900 lekësh, e barabartë me 27 lekë në muaj.

IV. PAGESA E KONTRIBUTEVE

Në kuptim të neneve 13 dhe 15 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të neneve 8, 9 dhe 11 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, punëdhënësi detyrohet të derdhë çdo muaj, në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Punëdhënësi detyrohet të paraqesë çdo muaj në agjensitë e sigurimeve shoqërore të rrethit,

listën emërore të punonjësve, pagën mujore, pagën mbi të cilën është derdhur kontributi dhe masën e kontributit të derdhur për çdo të punësuar.

Punëdhënësi pajis të punësuarit e tij me "Librezën e kontributeve të Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore" dhe i plotëson ato çdo muaj, në datën e pagimit të pagës për pesëmbëdhjetë ditë të muajit. Pas datës 1.1.1994 vjetërsia në punë dhe shuma e kontributeve të paguara nga çdo person ekonomikisht aktiv, vërtetohet me librezën e kontributeve.

Të vetëpunësuarit i paguajnë kontributet në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore një herë në 3 muaj.

V. të ardhurat mbi të cilat paguhen kontributet

Në kuptim të nenit 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të nenit 10 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, të ardhurat mbi të cilat llogariten e paguhen kontributet janë:

1. Paga që jep punëdhënësi sipas një kontrate pune, e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale dhe më e madhe se paga maksimale, e përcaktuar në pikën II të këtij vendimi.

2. Të ardhurat nga një punë e dytë ose nga një punë tjetër, të cilat raportohen te punëdhënësi kryesor dhe kontributet që rrjedhin prej tyre, nuk duhet të tejkalojnë pagën maksimale të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi.

3. Të ardhurat nga vetëpunësimi, pavarësisht nëse personi është i punësuar. Në rastet kur personi është i punësuar tek një punëdhënës dhe njëkohësisht është i vetëpunësuar, kontributet do të paguhen si i punësuar dhe për diferencë si i vetëpunësuar, deri në pagën maksimale të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi.

Nuk quhen të ardhura nga veprimtaria ekonomike dhe nuk u nënshtrohen kontribucioneve, përfitimet nga ligji i Sigurimeve Shoqërore, kompensimet nga rritja e çmimeve, dhuratat, të ardhurat nga detyrimi për ushqim sipas Kodit Civil dhe shpërblimet nga fondi i veçantë.

VI. PAGESA E përfitimeve

Pensionet e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore, të ardhurat që përfitojnë personat e siguruar për lejen e barrëlindjes, shpërblimet për lindjen e fëmijëve dhe pagesat për vdekje, paguhen nga zyrat e financës së komunave, për llogari të fondeve të sigurimeve shoqërore.

Data e pagimit të pensioneve caktohen nga këshilli i komunës. Zyra e financës e komunës përgjigjet për shpërndarjen e rregullt dhe korrekte të pensioneve.

Drejtoritë e Sigurimeve Shoqërore i dërgojnë zyrtarisht, zyrës së financës të komunës urdhërpagesat tip për pagimin e pensioneve, të cilat janë të plotësuara qartë, sakt dhe pa korrigjime. Urdhërpagesa është akt autorizativ, ndërsa pagesa e shumës së pensionit dokumentohet me listëpagesë

Drejtoritë e Sigurimeve Shoqërore, në datën e përcaktuar, pajisin me çek pagesë për tërheqjen e mjeteve monetare për pagimin e pensioneve, personin e autorizuar nga ana e kryetarit të komunës.

Për shërbimin e pagimit të pensioneve, drejtoritë e Sigurimeve Shoqërore, paguajnë në favor të komunës një komision në masën 0,5 për qind të shumës së paguar.

VII. Marrëdhëniet administrative e financiare ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor, bankave, Ndërmarrjes së Postave dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal të rregullohen me udhëzime të përbashkëta.

VIII. Ngarkohet Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, të nxjerrë udhëzimin për zbatimin e këtij vendimi.

IX. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.73, datë 30.1.1998, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko